



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA STUDIMI NË EMIRATET E BASHKUARA ARABE

VITI AKADEMIK 2019-2020

Universiteti Khalifa i Teknologjisë dhe Shkencës në Emiratet e Bashkuara Arabe ofron bursa të plota studimi për studentët në programe e saj të studimit. Universiteti Khalifa është një universitet me fokus shkencor i themeluar në vitin 2007 me një dekret të lëshuar nga Presidenti i Emirateve të Bashkuara Arabe, i cili u krijua për të mbështetur një ekonomi të bazuar në dije, e cila do të kontribuojë në të ardhmen e shtetit.

Universiteti Khalifa ofron bursë mujore për studentët gjatë periudhës së studimit, si dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve të nevojshme në 16 programe studimi për Master në fushat e shkencave inxhinierike dhe në programet doktorale në gjeologjinë e naftës dhe në shkencat inxhinierike.

Kandidatët e interesuar duhet të ndjekin udhëzimet në faqen web: <https://admissions.kustar.ac.ae/pg/Home/About>. Dokumentet e kërkuara nga universiteti duhet të skanohen dhe të ngarkohen online në formatin e specifikuar. Kopjet e paraqitura personalisht, të dërguara me email ose me postë nuk do të pranohen.

Afati i fundit i aplikimit është 30 Prill 2019.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresave në web-site:

<https://www.ku.ac.ae/admissions/graduate-admissions/>

<https://www.ku.ac.ae/admissions/graduate-admissions/graduate-admissions-required-documents/>

<https://www.ku.ac.ae/admissions/graduate-admissions/graduate-admissions-procedure/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS